



REPUBLIKA E KOSOVË REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. _____
 Dep. _____
 Nr. llog. _____
 Nr. folio _____
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. _____
 Prot. No. 03-02/3444
 Data _____
 Datum 24.10.2017
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2438-17, për Zyrtarin e lartë z.Hysen Azemi – Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Arkivave, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2438/17, për Zyrtarin e lartë, z.Hysen Azemi, Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Arkivave, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Azemi (DPK-03-02-2986-17), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Azemi është deklaruar se se për rastin të cilin e ka identifikuar AKK-ja ai ka menduar se duke qenë si biznes pasiv nuk përbën konflikt interesi.

Ndërkohë, z.Azemi, i ka bërë ndryshimet e nevojshme dhe në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë informacionet mbi ndryshimet në biznesin N.Sh.“Arkos – Arkivisti kosovar” (DPK/Dpki-03-02/3296/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z.Hysen Azemi tashmë ka hequr dorë nga funksioni menaxhues në këtë biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shaip Havolli /

